




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0078642-3/26, dt.12.01.2026
Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 51, paragrafi 1, dhe nenit 53, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2009); nenit 3, paragrafi 1 dhe 2, dhe neneve: 7, 8, 9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë; si dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 61, paragrafi 1, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 12.01.2026; sjell këtë:

VENDIM
Për formimin e Komitetit për Komunitete

- Me këtë Vendim FORMOHET Komiteti për Komunitete në këtë përbërje:
 - 1.1 Fisnik Suma - nga subjekti politik PDK,
 - 1.2 Armend Begu - nga subjekti politik LVV,
 - 1.3 Xhylljeta Imeri - nga subjekti politik LDK,
 - 1.4 Flamur Vojvoda - nga subjekti politik NISMA,
 - 1.5 Gjergj Beka - nga subjekti politik AKR,
 - 1.6 Jeton Ujkani - nga subjekti politik FeD,
 - 1.7 Fitim Terziqi - nga komuniteti turk,
 - 1.8 Dzenita Sabani - nga komuniteti boshnjak,
 - 1.9 Sibela Fetahu - nga komuniteti egjiptian,
 - 1.10 Hamide Hyseni - nga komuniteti ashkali, dhe
 - 1.11 Sadete Gashiani - nga komuniteti rom.
- Komiteti për Komunitete është përgjegjës për:
 - 2.1 Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe bënë rekomandim në Kuvendin e Komunës;
 - 2.2 Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht;
 - 2.3 Për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor;
 - 2.4 Sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të komuniteteve brenda komunës.
- Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.
- Komiteti për Komunitete e dorëzon në Kuvendin e Komunës raportin vjetor informues për punën e tyre më së largu deri në fund të muajit mars të çdo viti për vitin paraprak.
- Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
- Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
1 x 1 MAP
1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të Komitetit për Komunitete

